



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:111217

Datë: 19.09.2024

Numri i dokumentit: 06181697

P.nr.80/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit K.H. nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Pushtimi i paligjshëm i pronë së paluajtshme nga neni 259 par.2 të KP,K-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.67/12 e datës 22.03.2017, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 17.09.2024, në të cilin ishin të pranishëm prokurorja e shtetit Vyrtyte Gërvalla, përfaqësuesja e palës së dëmtuar L.S., i pandehuri K.H. dhe mbrojtësi me autorizim av.R.M., më dt.17.09.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 18.09.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: K.H. nga i ati B..., e ëma H..., e vajzërisë H..., data e lindjes... në komunën e Vushtrrisë, me vendbanim në komunën e Vushtrrisë, me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, e pa punë, e pa martuar, e gjendjes së mesme ekonomike, më parë e pa gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 362 paragrafi 1 pika 1.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK),

REFUZOHET AKUZA

SEPSE: Që nga viti 2002 e tutje, në fshatin Nadakovc, komuna e Vushtrrisë, në mënyrë të kundërligjshme, e ka uzurpuar pronën e paluajtshme dhe atë pronën e cila gjendet në vendin e quajtur “Barnovc” – zona Kadastrake Nadakovc, të parcelës kadastrale me numër 174 sipas fletës poseduese numër 42 që ka sipërfaqen prej 00.73.00 ha- Zona Kadastrale-Nadakovc, e cila është pronë shoqërore e N.SH.B “Elan” nga Vushtrria, e e cila është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit,

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale Pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 paragrafi 2 të KPRK-së

Shpenzimet e procedurës gjyqësore bien në barrë të kësaj gjykate.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr. 67/12 e datës 22.03.2017, kundër pandehurit K.H. nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Pushtimi i paligjshëm i pronë së paluajtshme nga neni 259 par.2 të KPRK-së,, nga e cila aktakuzë është tërhequr prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 17.09.2024.

Prokurorja e shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se pas shqyrtimit të të gjitha provave të cilat gjenden në aktakuzë, si dhe provave shtesë që janë administruar në gjykatë me propozimin e palëve, prokurori i shtetit tërhiqet nga ndjekja penale në raport me të pandehurin K.H. për veprën penale nga neni 259 par.2 i KPK-së, sipas aktakuzës PP.II.nr.67/2012.

Kjo për arsyeje se nga të gjitha provat nuk është arritur që të vërtetohet që i njëjti ka bërë uzurpimin e kundërligjshëm të kësaj prone dhe atë në vazhdimësi nga viti 2002 e deri në vitin 2017, dhe kjo pasi gjendja faktike që i ngarkohet të pandehurit është e tëra e mbështetur në një shkresë “informatë mbi pronat e uzurpuara” që i është drejtuar AKP-së, zyra rajonale në Mitrovicë, nga ndërmarrja Elan ku figuron evidentimi i parcelës kontestuese si dhe të dhënat mbi uzurpatorin ku figuron emri i të pandehurit K.H., por që kjo shkresë si e tillë nuk është e mjaftueshme për të vërtetuar një dyshim të bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale kjo për shkak se nuk kemi asnjë provë tjetër mbështetëse që e vërteton faktin se i pandehuri është uzurpator i pronës kontestuese, andaj ky standard si i tillë duke u bazuar vetëm në këtë informatë nuk mundet të zbatohet se i njëjti e ka kryer këtë vepër penale. Edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve siç është dëshmitari i dëgjuar në seancën e djeshme N.S., nuk është vërtetuar se i pandehuri e ka uzurpuar këtë pronë, ku i njëjti deklaroi se “nuk e ka parë asnjëherë as të pandehurin e as ndonjë person tjetër të ketë punuar këtë pronë”.

Po ashtu nga dëgjimi i dëshmitarit T.T. me datë 22.03.2017, nuk është vërtetuar se i pandehuri është parë duke e shfrytëzuar këtë pronë në mënyrë të kundërligjshme ku i njëjti thotë se “paraqitja e kallëzimit penal respektivisht evidentimit të të pandehurit si uzurpator e kam bërë në bazë të informatave prej rojtarëve të fushës siç i referohet ai” mirëpo nuk kemi asnjë procesverbal të vetëm, asnjë shkresë të vetme të përpiluar nga personi pra rojtari dhe tërë kjo ka mbetur vetëm një bisedë e brendshme mes dëshmitarit në fjalë dhe personit siç duket se ka pasur përgjegjësi në monitorimin e këtyre pronave. Po ashtu, në shkresat e lëndës evidentohet një padi e bërë nga paditësi N.SH.B Elan Vushtrri ndaj të pandehurit G.H. i cili është vëllau i të pandehurit, e që tregon faktin se për këtë çështje veçse ka qenë duke u zhvilluar një proces gjyqësor në fushën civile ndaj një personi tjetër, e cila padi është refuzuar nga gjykata.

Përkundër faktit se i pandehuri sipas provave në shkresat e lëndës nuk e ka uzurpuar pronën, nuk është kontestuese se kjo pronë shfrytëzohet kundërligjshëm nga dikush tjetër, andaj meqenëse edhe uzurpimi paraqitet në trajtën e vazhdimësisë dhe vazhdon edhe në ditën e sotme palës së dëmtuar në çdo kohë i’u jepet mundësia që për këtë çështje të paraqes kallëzim penal të ri ku

duhet nga organet e ndjekjes të vërtetohet dhe të merren veprime në drejtim të identifikimit të personit i cili është uzurpatori kësaj prone.

Bazuar në të gjitha këto rrethana, prokurori i shtetit për shkak se asnjëra nuk arrin të vërtetoj dyshimin e bazuar mirë që është kryer kjo vepër penale, ashtu siç deklaroi edhe më lartë tërhiqet nga ndjekja penale në këtë çështje.

Gjykata duke u bazuar në nenin 362 par 1 në par 1.1 të KPPK-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasi që, prokurorja e shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor pas administrimit të provave është tërhequr nga ndjekja penale lidhur me akuzën, e cila ka qenë objekt i shqyrtimit në këtë çështje penale dhe atë në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor.

Vendimin lidhur me shpenzimet procedurale gjykata e ka marr konform dispozitave të nenin 453 par.1 të KPRK-së

Andaj, gjykata duke u bazuar në të lartcekurat ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.80/2017, datë 19.09.2024

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.